



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 120
Prishtinë, më 15 korrik 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 KORRIK 2010**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme plenare,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Prishtinën,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës,

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare,
12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Sala Berisha-Shala, Ibrahim Makolli, Fatmir Rexhepi, Gjylnaze Sylja, Nait Hasani, Myrvete Pantina, Rita Hajzeraj-Beqaj, Driton Tali, Riza Smaka, Nurishahe Hulaj, Zef Morina dhe kryeministri Hashim Thaçi.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme

Procesverbali i mbledhjes plenare, të mbajtur më 1 dhe 5 korrik 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi apo ministrin Ahmet Shala, lidhur me publikimin e kontratës për dhënie me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës.

Kryeministri Hashim Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Naim Rrustemi** parashtroi pyetje për ministren, Justina – Pula-Shiroka lidhur me ofrimin e shërbimeve të Elektroekonomisë së Serbisë në pjesën veriore të Kosovës.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti **Rexhep Hoti** parashtroi pyetje për ministren, Edita Tahiri lidhur me projektin “e-qeverisja” të Ministrisë së Administratës Publike dhe funksionimin e tij.

Në mungesë të ministres Tahiri, kryeministri **Hashim Thaçi**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Hoti.

Deputeti **Rexhep Hoti**, parashtroi pyetje për ministrin, Haki Demolli, lidhur me kompletimin e Njesisë së Transportit Përcjellës dhe Njesisë së Transportimit të Burgosurve, për ta kryer këtë shërbim.

Ministri **Haki Demolli**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Hoti.

Deputetja **Zylfije Hundozi**, parashtroi pyetje për ministrin, Haki Demolli, lidhur me mos ekzekutimin e lëndëve nga gjykatat.

Ministri **Haki Demolli** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputetja **Zylfije Hundozi**, parashtroi pyetje për ministrin, Mahir Yagcilar, lidhur me licencimin e inxhinierëve të ndërtimtarisë dhe arkitektëve.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Hundozi.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtroi pyetje për ministrin, Blerand Stavileci, lidhur me ndikimet eventuale në rritjen e prodhimtarisë bujqësore dhe të punësimit, pas privatizimit të deritanishëm të tokave bujqësore.

Ministri **Blerand Stavileci** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kurteshi.

Deputeti **Driton Tali**, parashtroi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi apo zv.kryeministrin, Hajredin Kuçi lidhur me krijimin e grupeve punuese për zbatimin e strategjisë për veriuin e Kosovës.

Zv.kryeministri, **Hajredin Kuçi** , iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje për ministrin, Lutfi Haziri, lidhur me mos shpalljen publike të pozitave të lira, moszbatimin e përkrahimit të detyrave të punës, funksionimin e Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Ankesave, dosjet e Personelit dhe rregullimin e statusit juridik të nëpunësve civil, në Ministrinë që ai e drejton, në pajtim me dispozitat ligjore, referuar në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ministri **Lutfi Haziri**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Enis Kervan**, parashtroi pyetje për ministrin, Fehmi Mujota, lidhur me masat që do të ndërmerren për integrimin e pjesëtarëve të komunitetit turk në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri **Fehmi Mujota**, iu përgjigj pyetjes së deputetit Kervan.

Deputetja **Gjylnaze Syla**, parashtroi pyetje për ministrin, Bujar Bukoshi, lidhur me kohën e procedimit në Kuvend të Projektligjit për sigurimet shëndetësore.

Ministri **Bujar Bukoshi**, iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit mjedisor

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për vlerësimin e ndikimit mjedisor.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se nxjerrja e Projektligjit për vlerësimin e ndikimit mjedisor, është shumë nevojshme sepse në ligjin ekzistues disa gjëra nuk janë paraparë si dhe nuk ka qenë i harmonizuar tërësisht me direktivat më të reja të legjislacionit të BE-së, nga kjo fushë.

Në vazhdim tha se ky projektligj ka për qëllim parandalimin e ndikimeve negative për mjedisin, përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Më tej theksoi se projektligji adreson të gjitha çështjet për rregullimin e resurseve mjedisore, administrimin e lejeve mjedisore, vlerësimin dhe raportimin e ndikimeve të projekteve të caktuara në mjedis.

Projektligji përbëhet prej 7 kapitujve me 42 nene, dhe për te nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë, tha ai.

Në fund ministri Yagcillar, ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për vlerësimin e ndikimit mjedisor.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për vlerësimin e ndikimit mjedisor.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Selviqe Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Naim Maloku, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Drita Kadriu, Donika Kadaj – Bujupi, Hajdin Abazi, Adem Hajdaraj, Riza Smaka, Kaqusha Jashari dhe ministri Mahir Yagcillar, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për vlerësimin e ndikimit mjedisor.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Ministri **Lutfi Zharku** tha se emërtimi i Ligjit për konkurrencën, i cili është në fuqi, nuk ka qenë adekuat, kurse me këtë projektligj përcaktohet qartë emërtimi i tij.

Në vazhdim tha se Projektligji të cilin po e diskutojmë sot, përcakton në mënyrë të qartë kompetencat e Autoritetit të konkurrencës dhe mbrojtjen nga konkurrenca joligjore. Me

këtë projektligj përcaktohet procedura për fillimin dhe zhvillimin e hetimeve në rast të marrëveshjeve të ndaluara, tha ai.

Më tej, ai tha se pas miratimit, ky ligj do të ketë zbatim për të gjitha format e parandalimit, keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Kosovës ose jashtë territorit të vendit tonë, nëse këto veprime shkaktojnë efekte në Kosovë.

Në fund ministri Zharku, ftoi deputetët për miratimin në parim, të Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha - Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Shkumbin Demaliaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç, si dhe deputetët: Fatmir Rexhepi dhe Gjylnaze Syla, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për qytetin e Prishtinës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Qytetin e Prishtinës.

Ministri **Sadri Ferati** tha se nxjerrja e Projektligjit për qytetin e Prishtinës është obligim që del nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim tha se qëllimi i këtij Projektligji është rregullimi i bazës ligjore për statusin e qytetit të Prishtinës, kompetencat e posaçme, formën e organizimit të ri dhe përgjegjësitë e organeve të qytetit të Prishtinës, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Më tej ai tha se në hartimin e këtij Projektligji janë përdorur praktika të shumë vendeve evropiane si: Gjermanisë, Spanjës, Sllovenisë, Maqedonisë etj.

Në fund ministri Ferati, ftoi deputetët për miratim në parim, të Projektligjit për qytetin e Prishtinës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për qytetin e Prishtinës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Riza Smaka, Fatmir Rexhepi, Emrush Xhemajli, Naim Rustemi, Mimoza Ahmetaj, Gjylnaze Syla, Arsim Bajrami, Naser Rugova, Teuta Hadri, Berim Ramosaj, Abdyl Ymeri, Melihate Termkolli, Hydajet Hyseni, Myzejene Selmani, Gani Buçinca, Flora Brovina, Driton Tali dhe ministri Sadri Ferati, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër-----5,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Qytetin e Prishtinës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Ministri **Mahir Yagcilar** tha se në nxjerrja e këtij ligji është me rëndësi për faktin se me ligjin ekzistues ka disa çështje të cilat nuk kanë qenë të përfshira, ashtu siç nuk ka qenë i harmonizuar me direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian.

Në vazhdim tha se ky projektligj synon të rregullojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, mbrojtjen e mjedisit dhe të ndikojë në zhvillimin social-ekonomik të Kosovës.

Më tej theksoi se Projektligji adreson çështjet që kanë të bëjnë me; ujërat sipërfaqësor, liqenet, rezervarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë etj si dhe çështjet që lidhen me menaxhimin e tyre.

Projektligji parasheh edhe formimin e Këshillit Ndërmënyor për Ujërat, në vend të Këshillit Kombëtar për Ujërat, si dhe formimin e dy njësive rajonale për administrimin e pellgjeve ujore, theksoi ai. Projektligji mundëson të drejtën e qytetarit për të jetuar në një ambient më të pastër dhe më të pasur, tha ai në fund duke i ftuar deputetët për miratim në parim të Projektligjit për ujërat e Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ujërat e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elheme Hetemi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Zef Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Haset Cakolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integritim, Branisllav Grbiç, si dhe deputetët: Luljeta Shehu, Nurishahe Hulaj, Gjynaze Syla dhe ministri Mahir Yagcilar, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----62,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ujërat e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritim Evropiane dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit, Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ministri **Sadri Ferati** tha se prona komunale është një nga temat e cila një kohë të gjatë po e sfidon pushtetin lokal në Kosovë.

Në vazhdim tha se projektligji përcakton procedurën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale dhe këmbimin e saj me pronë të paluajtshme në pronësi shoqërore, nën administrimin e Agjencisë së Privatizimit.

Në fund ministri Ferati, ftoi deputetët për miratim në parim të Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Zylfije Hundozi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së,

Synavere Rysha, në emër të Grupit Parlamentar “7+” , Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slllobodan Petroviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Vladimir Todoroviç, si dhe deputetët: Ismajl Kurteshi dhe Fatmir Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër-----1,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, Komisionin për Integritet Evropian dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional. Kuvendi miratoi amendamentin nr. 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, dhe amendamentin nr. 15 të propozuar në Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, e ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një, amendamentet e Komisionit funksional. Kuvendi miratoi amendamentin nr. 1, 2 a), 3, 4, 6, 7 a), 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 24 a), dhe amendamentin nr. 25, të propozuar në Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim tekstin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----59,
Kundër-----3,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

11. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar i LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti Alush Gashi emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme, në vend të deputetit Ismet Beqiri.
2. Deputeti Ismet Beqiri emërohet anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetes Luljeta Shehu.

12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar raportin e Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, dhe Kuvendit i ka rekomanduar përzgjedhjen e kompanisë “Grant Thornton”, Prishtinë që të bëjë auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2008 dhe 2009.

Deputeti **Haki Shatri** në emër të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, paraqiti arsyetimin e rekomandimit dhe ftoi deputetët për miratim të këtij rekomandimi.

Kryesuesi në vazhdim hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,

Kundër-----0,

Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale